



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN  
DEGA NË DRAGASH – OGRANAK U DRAGAŠU – DRAGASH BRANCH

---

**C.nr.4/18**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË DRAGASH**, trupi gjykues në përbërje prej gjyqtarit Bekri Vehapi - kryetar dhe gjyqtarëve porotë Hazër Ramadani dhe Servete Emini - anëtar, me Bashkëpunëtorin Profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike të paditësit A. M. nga fshati... – Komuna Dragash, te cilin e përfaqëson S.B. nga Dragashi, kundër të paditurës R. M. nga qyteti Wien, Rr...Austri, tani me adresë të panjohur, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. N. K., për shkak të zgjidhjes së martesës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor jo publik, me datën **30.04.2018** mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. ZGJIDHET me shkurorëzim martesa**, e lidhur në mes të paditësit - bashkëshortit A. M., nga fshati.. – Komuna Dragash dhe të paditurës - bashkëshortës R. M., nga qyteti Wien,Rr... Austri, e lidhur më 28.04.2014, pranë zyrës së Ofiqarisë në Llopushnk – Komuna Dragash, e regjistruar me numër rendor..., dhe me numër të referencës...
- II.** Paditësi do të mbaj tani mbiemrin e vet të mëparshëm “ K...”
- III.** Me shpenzimet e procedurës ngarkohet paditësi

## Ar sy e t i m

Paditësi A. M. nga fsh.. – Komuna Dragash, pranë kësaj gjykate ka paraqitur nepermjet të autorizuarit të tij av.S. B. nga Dragashi padinë kunder të paditurës R. M. nga qyteti Wien, B., S. 39, 45/7 13, Austri, tani me adresë të panjohur, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. N. K. avokat, duke cekur se më të paditurën kanë lidhur martesë ndermjet veti më dt. 28.04.2014, para zyrtarit të ofiqarisë në Ll., komuna Dragash. Nga kjo martesë nuk kanë lindur fëmijë. Menjëher pas lidhjes së martesës e paditura R. ka shkuar në Austri, dhe se asnjë ditë nuk ka qëndruar në Kosovë – fshatin..., por të njëjtën ditë ka udhëtuar për në Austri qytetin Wien, ku edhe ka jetuar. Paditësi nga dita kur e paditura ka shkue në Austri ka tentuar që me të njëjtën të bie në kontakt në adresën ja ka lënë por në asnjë mënyrë më nuk ka mundur që të kontaktoj, gjerë më ditën kur e ka shtruar padinë. Gjithashtu ka potencuar se në vitin 2016 paditësi ka rregulluar vizen e përkohshme për Slloveni dhe ai nga Sllovenia ka shkuar në Wien të Austrisë për ta kërkuar te pditurën dhe për të bashkëjetuar, por kot pasi që të njëjtën as që e ka gjetur në atë adresë e as që e din kush se ku gjendet. Poashtu i ka propozuar gjykatës njëherit që të paditurës të i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, ngase e njëjta nuk gjindet në adresën e dhënë e as që dim se ku gjindet andaj i ka propozuar gjykatës që ta zgjithë martesën.

Pasi që e paditura - bashkëshortja jeton në botën e jashtme, gjykata nuk ka mbajtur seancë të pajtimit, konform nenit 76 par.1 pika 2 të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK).

Gjykata me propozimin e palës paditëse, të paditurës i'a caktoi përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve konform nenit 79.3 të LPK-së.

Edhe gjatë shqyrtimit kryesor paditësi nepermjet të autorizuarit të tij ka qëndruar pranë padisë së ushtruar, ngase qysh nga lidhja e martesës nga dt. 28.04.2014, asnjë ditë palët ndërgjyqëse nuk kanë jetuar së bashku, edhe pse e paditura ka marr për obligim dhe i ka marrë 10.000,00 € (dhjetë mijë euro), para për t'ia siguruar vizën dhe për të jetuar së bashku në Austri, nga ajo ditë e gjerë më sot, asnjë herë nuk janë takuar dhe as që janë dëgjuar me telefon, ngase këtu e paditura nuk lajmërohet në adresën që e ka paraqitur në momentin e lidhjes së martesës. Andaj nga këto arsye ka kerkuar aprovimin e kërkesëpadisë.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurës av. N. K. nga Dragashi gjatë shqyrtimit kryesor, ka theksuar se në rastin konkret objekt kontesti është zgjidhja e matesës në mes të palëve , krejt të involvuara si në padi. Me nenin 68 të LPK-së, parashihet se martesë të zgjidhet vetëm permes gjykatës. Në vazhdim në nenin 69 të LPK-së, parashifen kushtet për zgjidhjen martesës dhe atë kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta, kështu që pas administrimit të provave në këtë çështje gjykata mund të vendos në mënyrë meritore.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata me propozimin e palëve ndërgjyqëse ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat si në vijim: Certifikatën e martesës me numër

rëndor..., të lëshuar nga zyra e ofiqarisë në Ll., Komuna Dragash, shikimi i raportit të QPS-së me numer reference..., të dt. , bëhet shiqimi në Aktvendimin me dt. 13.04.2018 ku është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm av.N. K.

Gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

**Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.**

Nga çertifikata e martesës me numër rëndor..., të lëshuar nga zyra e ofiqarisë në Ll.- komuna Dragash, të datës 28.07.2017 është vërtetuar se paditësi me të paditurën kanë lidhur kurorë pranë zyrës së ofiqarisë në Ll. Komuna Dragash, më datë 28.04.2014, e regjistruar me numër rëndor... dhe me numër të referencës...

Nga shiqimi në raportin e QPS-së me numer reference ... të dt. 20.03.2018 gjykata ka vërtetuar se Organi i QPS-së në Dragash ka bërë përpjekje për pajtim mes bashkëshorteve të cekur më lartë por pas hulumtimit në teren ka ardhur në dijeni se e paditura R. M. jeton jashtë vendit dhe të njejtit bashkeshort nga kjo martes nuk kanë lindur femijë, dhe në kuptim të dispozitave të nenit 76 par.1 pika 2 të LFK-së ka deklaruar se nuk ka nevojë që të zhvillohet seanca e pajtimit mes bashkëshorteve. ka propozuar që kjo martesë të zgjidhet me shkurorëzim.

Nga shiqimi në aktvendimin e kësaj gjykate të dt. 13.04.2018, është vërtetuar që të paditurës R. M., tani me adresë të panjohur, është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm av. N. K. , ku njëherit është nxjerr dhe shpallur në formë të shkruar dhe njëherit është bërë edhe shpallja e Aktvendimit në Gazetën Zyrtare të R. së Kosovës.

Sipas nenit 68 par. 1 të LFK-së është e paraparë se *“martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës”*. Me paragrafin 2 të këtij neni parashihet se *“njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente. Me nenin 69 të LFK-së, parashihet se “bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht, ose në mënyrë të vazhdueshme, ose për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pakthyeshme. Shkaqet e shkurorëzimit janë mesë tjerash: jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër të jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e pa arsyeshme, sëmundja psikike e pa shërueshme dhe pa aftësi të vazhduar për të vepruar, **ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit, si dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dy anshme”**.*

Poashtu në dispozitat e nenit 79 par.3 të LPK-së është paraparë se *“Gjykata do të caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm edhe në këto raste: a) në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë; ....”*.

Në bazë të provave të administruara, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për shkurorëzimin e kësaj martesë, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlerësimi i gjykatës për bazueshmërinë e kërkesëpadisë për shkurorëzim bazohet në dispozitat e nenit 68 dhe 69 të Ligjit për Familjen të Kosovës, pasi që bashkësia martesore në mes të ndërgjyqësve nuk është e mundur, të cilën bashkëshortët e kanë manifestuar edhe me mosinteresimin e tyre që të rivendosin bashkëjetesën martesore, si dhe duke u bazuar në faktin se bashkëshortët pas lidhjes së martesës kanë jetuar të ndarë, të cilin fakt e ka pohuar edhe vet paditësi nëpërmjet të autorizuarit të tij gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 449 par.1 dhe 2 si dhe nenit 81 par.2 të LPK-së, dhe për këtë e obligojë palen paditëse, pasi ka qenë propozimi i saj që të caktojë përfaqësuesin e përkohshëm,

Nga të lartë cekurat u vendos si më lartë, e konform nenit 143 të LPK-së, në lidhje me nenin 68 dhe 69 të LFK-së.

Bazuar në arsyet e dhëna u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË DRAGASH**

**C.nr.4/18, datë: 30.04.2018**

Bashkëpunëtori profesional  
Gjelbrim Gërdellaj

**Kryetari i trupit gjykues**  
**Bekri Vehapi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.